



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



## **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 09.10.2017,  
e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Muhedin Nushi, nënkryetar, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi, shef i GP-së (LDK), Ismail Kasumi (LDK), Naime Osmani (LDK), Shefki Gashi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Shefqet Sylejmani (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hetem Kupina (LDK), Merita Surkishi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Berat Lahu (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Lirie Avdiu (PDK), Laura Zherka (PDK), Egzona Podvorica (PDK), Mirlinda Sopi, shefe e GP-së (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Sami Boroci (AKR), Kimet Zeqa (AKR), Rejhan Vuniqi (AKR), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, përfaqësues i subjektit politik (PD), Abit Kastrati, Abetare Fazliu, përfaqësuese e subjektit politik (LB), dhe Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS).

**Munguan:** Vlora Dumoshi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahim (LDK), Misim Bajrami (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Shaip Shabani (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

**Të pranishëm** ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Halim Halimi, kryesues, i cili e hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

**Kryesuesi**, para se të fillonte me pikat e rendit të ditës, propozoi që pika e katërt “Propozimvendimi për miratimin e Planit zhvillimor të arsimit në komunën e Prishtinës”, të jetë si pikë e parë e rendit të ditës.

**Agim Gashi** gjithashtu shprehu mendimin që propozim i dhënë nga Drejtoria e Bujqësisë të jetë në fillim, që ka të bëjë një rast në fshatin Mramur, ku një qytetari i është djegur stalla dhe si pasojë ka dëme të konsiderueshme.

**Ferat Makolli**, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, tha se para disa ditëve e kam pranuar një kërkesë, se në fshatin Mramur, pronarit Fadil Gashi i është djegur stalla si pasojë e zjarrit dhe ka pësuar dëme shumë të mëdha materiale.

Ai propozoi që t’i dilet në ndihmë me një shumë minimumi 5.000 deri në 10.000 €. Gjithashtu propozoi që të themelohet një fond i veçantë për ndihma emergjente në raste të fatkeqësive të ndryshme natyrore, me një shumë minimale prej 100.000 €.

**Agim Gashi** tha se ky propozim i dhënë ka qenë vullnet jo vetëm i nivelit komunal, por edhe të atij qendror. Meqenëse Ligji për menaxhimin e emergjencave nuk i parasheh fondet e veçanta, ndërsa në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, siç është kjo fatkeqësi e kësaj familje, thirret Kuvendi dhe merret vendim. Sa i përket dhënies së ndihmës, GP i LDK-së pajtohet.

**Dren Kukaj**, drejtor i Drejtorisë së Pronës, propozoi që pika e pestë “Propozimvendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ndërmarrjes publike komunale “Hortikultura””, të hiqet nga rendi i ditës për shkak të disa problemeve që kanë dalë në raport me këtë pronë.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri merret vendimi që fermerit Fadil Gashi nga fshati Mramur, t’i ndahet ndihmë financiare dhe të hyjë si pikë e rendit të ditës.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ky**

## R E N D I D I T Ë S :

1. Propozimi për miratimin e Planit zhvillimor të arsimit në komunën e Prishtinës 2018-2022;
2. Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme;
3. Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale;

4. Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën janar-qershor 2017;
5. Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje";
6. Propozimvendimi për dhënien e ndihmës financiare fermerit Fadil Gashi, nga fshati Mramur, për kompensimin e dëmit;
7. Diskutim për Raportin vjetor të auditimit të pasqyrave financiare vjetore për vitin 2016;
8. Pyetje dhe përgjigje;
9. Të ndryshme.

## **Pika e parë**

### **Propozimi për miratimin e Planit zhvillimor të arsimit në komunën e Prishtinës 2018-2022.**

**Xhavit Rexhaj**, konsulent i angazhuar nga KEC në procesin e hartimit të Planit zhvillimor të arsimit në komunën e Prishtinës 2018 - 2022, dha sqarime lidhur me hartimit të këtij Plani.

Ai theksoi se në vitet e fundit kanë ndodhur disa zhvillime të reja dhe në tërë Kosovën po vërehet një sjellje e re në fushën e arsimit. Pra, e kemi Planin strategjik të zhvillimit të arsimit, fillimin e zbatimit të kornizës së Kurrikulës dhe Strategjinë kombëtare për sigurimin e cilësisë. Vlen të përmendet se me aplikimin e Kurrikulës nëpër të gjitha shkollat, ka një qasje shumë më serioze të mësimdhënësit.

**Genc Sherifi** në lidhje me koordinatoren e sigurimit të cilësisë, kërkoi të dijë se sa do të ketë kohë që ta bëjë sigurimin e cilësisë nëpër shkolla, a janë bërë trajnime dhe a janë paraparë trajnime të tilla.

**Agim Gashi** tha se në çdo shkollë po kërkohet caktimi i koordinorit të vlerësimit, kemi dymbëdhjetë koordinorë dhe deri më tani vetëm tre janë të licencuar. Gjithashtu tha se si është e mundur të kërkohet nga shkollat të caktohen koordinorët, ku në bazë të statistikës shihet se nuk kemi njerëz adekuat. Ndërsa sa u përket super-shkollave, çka ka ndodhur me to, dhe do të ishte mirë që ky plan t'i prekë edhe ato fusha. Lidhur me përdorimin e një shprehjeje, në faqet 34, 35, 36, përdoret shprehja "për të nxënë", kjo duhet gjithsesi të përmirësohet dhe të thuhet për "të nxënëit efektiv".

**Xhavit Rexhaj** tha se ekzistojnë dy koordinorë, koordinori i vlerësimit dhe ai i cilësisë. Po ashtu, ky Udhëzim administrativ për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të shkollës, parasheh që të ketë trup koordinues në shkollë, ndërsa koordinori i cilësisë ekziston në bazë të një udhëzimi tjetër administrativ, për të cilin parashihet të paguhet me një shumë të hollash.

**Sylejman Pireva**, sa i përket këtij Plani zhvillimor të arsimit, tha se është një model që mund t'u shërbejë edhe komunave të tjera, është i punuar me shumë seriozitet dhe me profesionalizëm. Ai kërkoi të dijë nga koordinori se a ka këmbim përvojash me modelin e shkollimit të arsimit në Shqipëri dhe kush janë autorët e këtij Plani të zhvillimit të arsimit në komunën e Prishtinës.

**Ylli Hoxha** ngriti një shqetësim lidhur me shkollat, duke thënë se ende kemi shkolla në komunën e Prishtinës ku zhvillohet mësim i kombinuar. Kjo është shumë shqetësuese të kemi ende klasë ku fëmija i klasës së parë dhe i klasës së tretë mësojnë bashkë me një mësues. Ndërsa shkollat satelitë dhe mësimi i kombinuar duhet urgjentisht të hiqen dhe të rritet niveli i prioriteteve që i ka DKA-ja në të ardhmen.

**Shefki Gashi** tha se sa i përket këtij Plani zhvillimor, më shqetëson fakti që asgjë nuk lidhet me praktikën e nxënësve të nivelit të shkollave të mesme, ndërsa sa u përket shkollave profesionale, kërkoj që rëndësi të veçantë t'i jepet pjesës së ushtrimeve, pra pjesës laboratorike sa i përket fushës së shkencave ekzakte.

**Kimet Zeqa**, lidhur me regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, theksoi se më parë ka qenë e nevojshme që fëmija ta marrë certifikatën mjekësore që është i shëndetshëm dhe mendimin e psikologut. Ndërsa sa u përket fëmijëve me nevoja të veçanta, duhet pasur një kategorizim për ata fëmijë. Sipas Udhëzimit administrativ, lejohet një fëmijë me nevoja të veçanta të regjistrohet në klasën e parë ose parashkollor.

**Hatixhe Hoxha** tha se sa i përket cilësisë në arsim, viteve të fundit ka ngritje. Këtë e dëshmon edhe fakti që komuna e Prishtinës është përzgjedhur për hartimin e Panit zhvillimor të arsimit 2018-2022 dhe pesë fushat që janë prekur. Sa i përket vërejtjeve të dhëna, janë të mirëseardhura dhe duhet të inkorporohen.

**Teuta Krasniqi** theksoi se sa i përket arsimit në përgjithësi, duket një degradim i madh në këtë fushë, ndërsa sa i përket cilësisë në shkolla, ka rëndësi të madhe mësimdhënësi si qaset në përgjithësi gjatë procesit mësimor.

**Hasime Krasniqi** kërkoi të dijë se a është ndërmarr diçka rreth pagesës së asistentëve të nxënësve me nevoja të veçanta.

**Ajnishahe Azemi** kërkoi që ky Plan të zbatohet me sukses, por njëherësh edhe zbatimi i Kurrikulës së re dhe arritja e qëllimeve të sistemit arsimor në të gjitha nivelet.

**Feti Mehdiu** shprehu mendimin se gjatë diskutimeve lidhur me këtë Plan, u dhanë disa vërejtje dhe sugjerime të arsyeshme. Ai njëherësh shprehu pakënaqësi lidhur me pikat e rendit të ditës që kanë të bëjnë me arsimin, sepse ato nuk vihen në fillim për diskutim, por gjithmonë mbeten për diskutim në pjesën e fundit të pikave të rendit të ditës.

**Imer Rusinovci**, bëri pyetje lidhur me hapësirën ligjore të veprimit në shkollë, që të ketë krahas masave stimuluese edhe masa ndëshkuese dhe të jetësohen në shkollë. Kjo duhet të jetë prioritet, që vërtetë të kemi një rezultat dhe një performancë më të mirë.

**Abetare Fazliu** kërkoi që Policia e Kosovës të jetë më e pranishme nëpër shkolla, për shkak të problemeve që po ndodhinë prej rrahjeve e deri te vrasjet.

**Laura Zherka** pyeti se a është paraparë mësimi tërëditor, kur e dimë se ne kemi shkolla ku procesi mësimor zhvillohet në dy deri në tri ndërresa. Po ashtu, në kuadër të këtij Plani zhvillimor a është paraparë ndonjë trajnim paraprak për përgatitjen e fëmijëve për të qenë pjesë e testit të PISA-së?

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 29 (njëzet e nëntë) vota për, u miratua Plani zhvillimor i arsimit në komunën e Prishtinës 2018-2020, me plotësime dhe sugjerime të dhëna nga anëtarët e Kuvendit.**

**Pika e dytë**

**Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme.**

**Muhedin Nushi**, nënkryetar, dha sqarime lidhur me këtë propozimrregullore, për gabimet teknike të cilat kanë qenë paraprakisht dhe janë korrigjuar. Po ashtu, theksoi se aty ku ka pasur gabime, adresat janë vendosur sipas zonave si janë definuar.

**Agim Gashi** theksoi se gjatë kësaj periudhe të aplikimit të rregullores me ndryshime nga rregullorja para saj, është kritikuar mjaft shumë me rritje të vlerave. Vlerat kanë qenë mjaft të fryra dhe nuk ka ndikuar ajo që të shtohet buxheti cilësor i Komunës së Prishtinës, vetëm se janë shfrytëzuar në mënyrë të padrejtë tatimpaguesit e komunës së Prishtinës.

Ai tha se këto vlera duhet të ulen dhe ulja e tatimit duhet të bëhet njësoj për shtëpi dhe banesa.

**Ylli Hoxha** tha se kemi pasur një ndryshim kur e kemi miratuar këtë rregullore, që të ngarkohen më pak objektet ose banorët, vlera e pronave të të cilëve vlen më pak, e të ngarkohen më shumë ata që vlerën e pronave e kanë më të lartë. Pra nuk bëhet fjalë për rritje të tatimit.

**Sami Boroci** tha se Grupi parlamentar i AKR-së do ta mbështesë miratimin e kësaj rregulloreje.

**Laura Zherka** bëri të ditur se Grupi parlamentar i PDK-së abstenon lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Lidhur me këtë, grupi i PDK-së në kuadër të degës është duke e shqyrtuar këtë propozimrregullore dhe propozimet do t'i dërgojmë me shkrim.

**Feti Mehdiu** tha se kjo rregullore ka një kualitet tjetër, andaj ne do ta përkrahim kështu si është.

**Fatos Dibra**, zyrtar nga Zyra ligjore, ceku se kjo rregullore ka qenë tash e një vit në diskutim publik. Gjatë kësaj kohe ka pasur ankesa të shumta nga qytetarët për gabimet teknike të rrugëve që janë bërë.

**Dren Kukaj**, drejtor i Drejtorisë së Pronës, tha se në fillim është bërë një vlerësim i ri në të gjitha pronat e komunës së Prishtinës. Në bazë të këtij vlerësimi të bërë e kemi ndërtuar një sistem prej dhjetë zonave, ku në mënyrë të barabartë është shpërndarë barra tatimore në të gjitha pronat e komunës së Prishtinës.

**Hatixhe Hoxha** bëri të ditur se në mbledhjen e KPF-së kemi shtruar disa vërejtje lidhur me propozimrregulloren.

**Naime Osmani** tha se jemi për uljen e tatimit në pronë në përgjithësi, por sa i përket zonave të pjesës rurale, disa fshatra i kanë paraqitur në zonën e nëntë e disa në zonën e dhjetë. Më intereson ta dijë se a e kanë marrë parasysh infrastrukturën e rregulluar dhe largësinë nga qyteti.

**Kryesuesi konstatoi se më 21 (njëzet e një) vota për, 8 (tetë) vota kundër (Agim Gashi, Besa Rafuna, Fadil Gashi, Fisnik Osmani, Hetem Kupina, Muhamet Nura, Naime Osmani, Shefqet Sylejmani) dhe 6 (gjashtë) abstenime (Ajnishahe Azemi, Egzona Podvorica, Laura Zherka, Lirie Avdiu, Merita Surkishi, Ismail Kasumi), u miratua Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme.**

**Pika e tretë**

**Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.**

**Muhedin Nushi, nënkryetar**, lidhur me këtë bëri të ditur se është bërë përshkallëzimi dhe përcaktimi i kufijve tarifor për një njësi dhe jo për një pronë në tërësi. Prona sipas madhësisë ndahet në njësi të posaçme, njësi të veçanta. Besojmë se ky është versioni më i mirë i mundshëm deri më tash.

**Kryesuesi konstatoi se më 24 (njëzet e katër) vota për, 3 (tri) vota kundër, (Besa Rafuna, Muhamet Nura, Shefqet Sylejmani) dhe 5 (pesë) abstenime (Laura Zherka, Merita Surkishi, Hazir Borovci, Ismail Kasumi, Lirie Avdiu), u miratua Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.**

**Pika e katërt**

**Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën janar – qershor 2017.**

**Kryesuesi konstatoi se më 14 (katërmëdhjetë) vota për, 12 (dymbëdhjetë) vota kundër (votimi është bërë me ngritje dore dhe mungojnë emrat e votuesve), u miratua shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën janar – qershor 2017.**

### **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje".**

**Genc Bashota**, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, theksoi se ky vendim ka kohë që është diskutuar në Kuvend, është mbajtur diskutimi publik dhe në bazë të projekteve është hartuar një plan detal. Pra, ekziston vetëm një ndryshim sa i përket rrugëve dhe trasesë, ndërsa sa u përket koeficienteve nuk ka ngritje, janë më të ulët sesa kanë qenë në plan rregullues.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 (njëzet e gjashtë) vota për, 1 (një) abstenim (Muhamet Nura), u miratua Vendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona lindje".**

### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për dhënien e ndihmës financiare fermerit Fadil Gashi, nga fshati Mramur, për kompensimin e dëmit.**

**Ferat Makolli**, drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, tha se sa i përket dëmit të shkaktuar ndaj këtij fermeri, ai është diku rreth 30 mijë €, andaj propozoj që minimumi i çmimit që duhet kompensuar duhet të jetë 10 mijë €.

**Bardha Dida - Rogova** kërkoi të sillen faturat për shpenzimin e mjeteve dhe komision ta bëjë vlerësimin se vërtetë këto të holla kanë shkuar për atë qëllim.

**Fatos Dibra** propozoi që paraprakisht të bëhet vlerësimi i dëmit nga një komision.

**Hatixhe Hoxha** kërkoi nga ekzekutivi sqarim në aspektin ligjor se sa do të jeta shuma e kompensimit.

**Kryesuesi konstatoi se më 25 (njëzet e pesë) vota për, 1 (një) abstenim, (Hatixhe Hoxha), u miratua Vendimi për dhënien e ndihmës fermerit Fadil Gashi, nga fshati Mramur, për kompensimin e dëmit në shumën deri në 10 mijë €.**

### **Pika e shtatë**

**Diskutim për raportin vjetor të auditimit të pasqyrave financiare vjetore për vitin 2016.**

**Osman Bllaca**, auditor i brendshëm, lidhur me raportin për pasqyrat financiare vjetore për vitin 2016, tha se na është sjellë nga Zyra Kombëtare e Auditimit në afatin kohor dhe Komuna është pajtuar me të gjitha të gjeturat dhe rekomandimet të cilat janë sjellë në këtë raport.

Në këtë raport gjithsejtë janë 26 rekomandime, të cilat janë dhënë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për Komunën e Prishtinës, gjegjësisht për pasqyrat vjetore financiare të cilat auditohen për të gjitha organizatat buxhetore.

Sa i përket Komunës së Prishtinës, ai tha se jemi komuna më e mirë sa i përket raportit të auditorit të jashtëm.

**Fisnik Osmani**, në emër të GP i LDK-së, tha se refuzojmë të diskutojmë për këtë pikë, përderisa nuk janë të pranishëm këtu kryetari, nënkryetari dhe pjesës dërmuese e ekzekutivit.

**Hatixhe Hoxha**, në emër të GP të LVV-së, e përgëzoi Komunën e Prishtinës për këto vlerësime që janë bërë, ndërsa sa u përket vërejtjeve të dhëna duhet të korrigojen dhe shpresoj se do të përkrahet.

**Berat Lahu** lidhur me raportin, shprehu mendimin se nuk ka parregullsi e as shkelje ligjore, por shqetësimi del nga ana e opozitës, e cila ka kërkuar ta trajtojë këtë raport para kohe dhe tash fare nuk merr pjesë.

**Kryesuesi** tha se trajtimi i raportit nuk është i parakohshëm, në muajin qershor i është dorëzuar kryesuesit dhe kryetarit.

**Ylli Hoxha** tha se është duke u diskutuar shumë lidhur me çështjen e kontratave mbi vepër. Njëra prej arsyeve është sepse ka limit të punësimeve, sepse Ministria duhet ta aprovojë kërkesën për secilin vend të punës, andaj janë të domosdoshme kontratat mbi vepër.

**Mbledhja përfundoi në orën 14:05.**

**Procesmbajtësja**  
**Luljeta Selimi**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Halim Halimi, jur. i dipl.**